

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RADO GROUP AL” SH.P.K.

KREU I

Ortakët dhe Baza ligjore

Sot, në datën 09.01.2025 (dy mijë e njëzet e pesë), themeluesi i përcaktuar si më poshtë:

KLODIAN RADO, i biri i Balil, lindur më 26.08.1978, në Gjirokastrë, banues në Rr. Mihal Grameno, Njësia Bashkiake nr.2, 1003, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr. **BB5216891** dhe nr. personal: **H80826056W**; në cilësinë e "Ortakut Themelues", me vullnet të lirë të plotë e në bazë të nismës së lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Kodin Civil në fuqi; ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar; ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; ligjin Nr. 5572018 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë; Ligjin Nr.10 385, datë 24.2.2011 "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve"; Ligjin Nr.9/2022, datë 27.1.2022 "Për Profesionin e Ndërmjetësit të Pasurive të Paluajtshme" vendosi të themelojë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **“RADO GROUP AL” SH.P.K.**

KREU II

Kuotat, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

- 1.1** Shoqëria **“RADO GROUP AL” SH.P.K.** bazohet në legjislacionin shqiptar që rregullon pozitën juridike të subjekteve të tilla.
- 1.2** Me këtë Akt Themelimi dhe Statut rregullohen këto çështje:
- emërtimi i shoqërisë;
 - lloji i shoqërisë;
 - adresa e selisë së saj;
 - periudha e kohëzgjatjes;
 - veprimtaria e shoqërisë, organet drejtuese;
 - emri dhe adresat e themeluesit;
 - procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret;
 - marrëdhëniet juridike të themeluesit të Shoqërisë, të drejtat e detyrimet e tij, aksesin e të tretëve pranë kësaj zyre dhe mënyrën e aplikimit të tyre për partneritet, llojin e partneritetit, rekrutimin apo punësimin e të asociuarve, mënyrën e bashkëpunimit me subjekte të tjerë privatë apo shtetërorë,



kohëzgjatjen e veprimtarisë, kriteret e karrierës brenda zyrës nga të interesuarit etj.

Neni 2

Emri dhe vula e shoqërisë

- 2.1** Shoqëria është person juridik privat, e organizuar sipas formës “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” dhe mban emrin **“RADO GROUP AL” SH.P.K.**
- 2.2** Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.
- 2.3** Vula e shoqërisë është në formë rrethi. Formohet nga logo e shoqërisë në mes, e cila rrethohet nga shkrimi **“RADO GROUP AL”** në pjesën e sipërme.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

- 3.1** Shoqëria **“RADO GROUP AL” SH.P.K.** do të ketë objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

a) VEPRIMTARI AVOKATORE (KONSULENCË DHE ASISTENCË LIGJORE):

- Këshillime juridike për të gjitha çështjet ligjore, të tilla si: kushtetuese, të drejtës ndërkombëtare, emigracionit, civile, penale, administrative, tatimore e financiare, etj., si dhe përfaqësim ligjor pranë të gjitha gjykatave dhe institucioneve dhe administrative;
- Kryerjen e cdo veprimi të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacioneve, apo themelimit të kompanive me qëllim kryerjen e investimeve në cdo fushë, e sidomos në fushën e energjitikës, turizmit, ndërtimit, industrive të ndryshme, por jo vetëm;
- Përgatitje të kërkesave ankimore kundër vendimeve gjyqësore, akteve të prokurorit, organeve të arbitrazhit apo të administratës shtetërore në përgjithësi;
- Hartimin e kontratave apo marrëveshjeve të tjera me palë private ose publike;
- Përfaqësimin e palëve gjatë proceseve kushtetuese, civile, administrative, familjare, etj fusha të së drejtës;
- Si dhe cdo veprimtari që lidhet me fushë.

b) VEPRIMTARI NDËRMJETËSIMI LIGJOR:

- Ndërmjetësimi për zgjidhjen e konflikteve apo mosmarrëveshjeve në të gjitha fushat e lejuara nga legjislacioni në fuqi.
- Ushtrimi i rolit të palës ndërmjetëse ndërmjet subjekteve private dhe publike, me qëllim arritjen e marrëveshjeve ndërmjet palëve.
- Pjesëmarrja dhe mbështetja në të gjitha fazat e ekzekutimit të marrëveshjeve të arritura përmes ndërmjetësimit.

c) VEPRIMTARI AKADEMIKE, TRAJNIMI, BOTIMI DHE LAJMESH NË FUSHËN E LIGJIT:



Hapjen dhe Menaxhimin e Akademisë së Ligjit:

- Organizimi dhe ofrimi i trajnimeve profesionale në fushën e ligjit për studentë, juristë, avokatë, gjyqtarë, ndermjetës, dhe profesionistë të tjerë ligjorë.
- Zhvillimi i programeve arsimore dhe profesionale për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me ligjin dhe shtetin e së drejtës.
- Organizimi i trajnimeve vazhduese, kurseve, seminareve, dhe workshopeve në lidhje me tematika bashkëkohore dhe praktike të fushës së ligjit.
- Çdo aktivitet tjetër që ka si qëllim promovimin dhe edukimin ligjor në Shqipëri dhe më gjerë.

Botimi dhe Publikimi në Fushën e Ligjit:

- Botimi i librave shkencorë, punimeve akademike, dhe raporteve analitike në fushën e ligjit.
- Hartimi dhe publikimi i studimeve ligjore mbi çështje të ndryshme me interes publik dhe profesional.
- Krijimi, redaktimi, dhe publikimi i revistave shkencore, përfshirë revista periodike në fushën e ligjit, me qëllim promovimin e kërkimit shkencor dhe përhapjen e informacionit profesional.
- Krijimi, redaktimi, dhe publikimi i një gazete ligjore (online apo ne leter) periodike për informimin e publikut mbi lajmet dhe zhvillimet e fundit në fushën e drejtësisë në Shqipëri dhe ndërkombëtarisht.
- Menaxhimi i platformave dixhitale për publikime dhe shpërndarjen e materialeve ligjore.

Promovimi dhe Zhvillimi i Ligjit në Shqipëri:

- Organizimi i aktiviteteve dhe fushatave për ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës.
- Mbështetja e reformave në drejtësi përmes studimeve, trajnimeve, dhe rekomandimeve praktike.
- Bashkëpunimi me institucione publike, organizata ndërkombëtare dhe kombëtare, dhe subjekte private për promovimin e standardeve ligjore dhe praktikave të mira në Shqipëri.
- Krijimi i qendrave kërkimore për analizimin dhe studimin e problematikave ligjore me qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

ç) VEPRIMTARI NE LIDHJE ME PASURITE E PALUAJTSHME DHE NDERTIMIT:

Ndërmjetësimi në Transaksionet me Pasuri të Paluajtshme:

- Ndërmjetësimi në blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme, përfshirë prona rezidenciale, komerciale, dhe industriale.
- Ndërmjetësimi në dhënien dhe marrjen me qira të pasurive të paluajtshme.
- Konsulenca dhe përfaqësimi i klientëve në negociata për transaksionet e pasurive të paluajtshme.
- Hartimi dhe administrimi i dokumentacionit juridik të nevojshëm për përfundimin e transaksioneve të pasurive të paluajtshme.



Veprime Juridike dhe Shërbime Mbështetëse:

- Hartimi i kontratave, marrëveshjeve, dhe çdo akti tjetër juridik për blerjen, shitjen, ndërrimin, apo transferimin e pasurive të paluajtshme.
- Konsultimi dhe zbatimi i procedurave ligjore për regjistrimin dhe certifikimin e pasurive të paluajtshme pranë institucioneve përkatëse.
- Asistenca juridike dhe administrative për klientët në lidhje me pasuritë e paluajtshme.

Ndërtimi dhe Rinovimi i Pasurive të Paluajtshme:

- Projektimi, ndërtimi, dhe mbikëqyrja e ndërtimeve të reja në përputhje me standardet dhe legjislacionin në fuqi.
- Rinovimi, rikonstrukcioni, dhe mirëmbajtja e pasurive të paluajtshme ekzistuese.
- Bashkëpunimi me kompani ndërtimi, arkitektë, dhe inxhinierë për realizimin e projekteve të ndërtimit dhe rinovimit.

Hapja dhe Menaxhimi i Qendrave për Ndërtim dhe Materiale Ndërtimi:

- Hapja dhe operimi i qendrave për menaxhimin e ndërtimeve dhe projekteve të pasurive të paluajtshme.
- Shitja, shpërndarja, dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit për projekte ndërtimi dhe rinovimi.
- Sigurimi i logjistikës dhe shërbimeve mbështetëse për zhvillimin e projekteve ndërtimore.

Veprimtari të tjera mbështetëse dhe plotësuese:

- Konsulenca në investime për pasuri të paluajtshme, përfshirë studime fizibiliteti dhe analiza tregu.
- Hartimi dhe zbatimi i strategjive për promovimin dhe shitjen e pasurive të paluajtshme.
- Organizimi i ankandeve dhe tregjeve për shitblerjen e pasurive të paluajtshme.
- Çdo veprim tjetër juridik ose administrativ i nevojshëm për realizimin e veprimtarisë së mësipërme.

d) VEPRIMTARI NË FUSHËN E TURIZMIT DHE OPERATORËVE DETARË

Krijimi dhe Operimi i Agjencie Turistike:

- Funksionimi si "operator turistik" në formën dhe kuptimin më të gjerë.
- Organizimi dhe menaxhimi i udhëtimeve me mjete tokësore, ujore dhe ajrore.

Shërbime për Klientët në Udhëtime:

- Ofrimi i ndihmës për klientët përmes pritjes, transferimit dhe shoqërimit në porte, aeroporte dhe stacione.
- Dhënia e udhëzimeve dhe informacioneve të ndryshme, përfshirë ato kulturore, gjeografike dhe teknike.

Veprimtari në Fushën e Operimit Detar:



- Funksionimi si operator detar për përdorimin dhe administrimin e mjeteve të lundrimit.
- Dhënia me qira e mjeteve të lundrimit, përfshirë anije, jahte, varka dhe çdo lloj tjetër mjeti lundrues për përdorim individual ose kolektiv.
- Përdorimi i mjeteve të lundrimit si mjete transporti për turistë, grupe udhëtarësh dhe mallra.
- Organizimi dhe menaxhimi i udhëtimeve dhe ekskursioneve ujore brenda dhe jashtë vendit.
- Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e mjeteve të lundrimit në përputhje me standardet teknike dhe ligjore.
- Ofrimi i shërbimeve të transportit detar për ngarkesa dhe udhëtarë, sipas nevojave të tregut.

Organizimi i Ekskursioneve dhe Turneve:

- Organizimi i ekskursioneve turistike dhe turneve brenda dhe jashtë vendit, përfshirë ekskursionet detare.
- Rezervimi dhe porositja e shërbimeve të akomodimit, hotelerisë dhe turizmit në përgjithësi.

Hapjen dhe Operimin e Muzeve

- Promovimi i Shqipërisë përmes hapjes dhe operimit të qendrave të informacionit dhe muzeve private me tematika të ndryshme.
- Themelimi i muzeve që promovojnë turizmin kulturor, fetar dhe historik në Shqipëri.
- Organizimi i aktiviteteve dhe ekspozitave për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1** Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Përgjithshme e ortakëve, sipas kuorumit përkatës vendos ndryshe.
- 4.2** Shoqëria **“RADO GROUP AL” SH.P.K.** gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKB-së.

Neni 5

Zyra Qendrore

- 5.1** Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën: “Rr. Themistokli Gërmenji, Pallati Ambasador 1, 8/4, Tiranë, Shqipëri.”
- 5.2** Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të



Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit përkatës.

KREU III

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve

- 6.1 Ortaku administron aktivitetin e shoqërisë në përputhje dhe konform objektit të saj. Gjithashtu, në përputhje me praktikën e mirë, administrohen edhe vlerat intelektuale dhe ekonomiko-financiare të shoqërisë.
- 6.2 Ortaku ka dijeni në çdo kohë për gjendjen dhe rezultatin ekonomiko-financiar të Shoqërisë dhe zotëron në çdo kohë të gjithë dokumentacionin me interes të saj.
- 6.3 Ortaku ruan të drejtën që në çdo kohë të tërhiqet nga pjesëmarrja në Shoqëri dhe të tjetërsojë pjesën e tij të kapitalit të investuar, në përputhje me rregullat e këtij statuti dhe ligjin përkatës.
- 6.4 Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet që ka deri në çastin e heqjes dorë dhe, nuk e ndalon atë në marrjen e të ardhurave përkatëse të siguruara nga shoqëria deri në atë moment.

Neni 7

Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10000 (dhjetë mijë) lekë i formuar në masë të plotë nga kontributi i Ortakut të Vetëm, dhe është i përbërë në një kuotë me vlerë nominale sipas ndarjes më poshtë. Çdo kuotë njësie ka të drejtën e (1) një vote. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:
 - a) Ortaku themelues Klodian Rado: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10000 (dhjetë mijë) lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 7.2 Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ana e ortakut të vetëm të shoqërisë.
- 7.3 Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Neni 8

Burimet financiare

- 8.1 Shoqëria krijon burimet e saj financiare nga ushtrimi i veprimtarisë së saj sipas objektit të përcaktuar.
- 8.2 Veprimtaria e funksionimit të shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut.
- 8.3 Veprimtaria ekonomike-financiare ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilanci të saj.

Neni 9



Pasuria e Shoqërisë

- 9.1** Pasuritë e shoqërisë përbëhen nga sendet e kontribuara prej ortakut themelues z. Klodian Rado, dhe nuk janë përfshirë në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 9.2** Në çastin e aderimit të një ortaku të ri në shoqëri, vlera e pasurive të shoqërisë do të konsiderohet si kontribut i ortakut themelues dhe në rast se me zhvillimin e aktivitetit do të krijohen pasuri të tjera, atëherë ato do të konsiderohen që janë në bashkëpronësi të ortakëve sipas vlerës së kapitalit që ata kanë investuar.

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 10.1** Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të cilësuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e cilësuar (tre të katërtat) e votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.
- 10.2** Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e cilësuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

KREU IV

Neni 11

Kuotat dhe Kalimi i Kuotave

- 11.1** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndërmjet palëve.
- 11.2** Transferimi i kuotave të ortakëve të shoqërisë brenda ortakërisë apo në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë është i kushtëzuar në çdo rast nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve ekzistues.
- 11.3** Ortaku, para se t'i transferojë në çdo formë kuotat e veta një ortaku ekzistues brenda shoqërisë apo një personi të tretë jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë ortakët ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në mënyrë përpjestimore sipas kuotave që zotërojnë në kapital të shoqërisë.
- 11.4** Në rast se të gjithë ortakët nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve nga njoftimi apo deklarojnë se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lirë të transferojë kuotat e tij tërësisht apo pjesërisht në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë.
- 11.5** Në rast se një pjesë e ortakëve ekzistues përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve dhe deklarojnë se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar t'i transferojë kuotat e tij në drejtim të tyre në mënyrë të barabarte (dmth në rast se dy ortakë shprehin dëshirën për blerjen e kuotave, ato do t'i shiten të dy ortakëve në mënyrë të barabartë, pra 50% secilit).



Neni 12

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 12.1** Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 12.2** Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 12.3** Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votes në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

Neni 13

Fondi Rezervë

- 13.1** Shoqëria krijon fondin rezervë për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve të krijuara nga veprimtaria e saj ekonomike.

Neni 14

Përdorim i të ardhurave

- 14.1** Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 14.2** E ardhura e krijuar nga aktiviteti i Shoqërisë, pasi zbriten shpenzimet e bëra dhe amortizimi i mjeteve të përdorura për çfarëdolloj aktiviteti, pagesat për tatimet dhe taksat vendore, pagat apo shpërblimet për punën e të punësuarve, asistentëve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë, pagesat e bëra për rritjen e investimeve në aktivitetin e Shoqërisë, ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me kontributin e tyre.

Neni 15



Pasqyrat Financiare

15.1 Të ardhurat dhe pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bazë të pasqyrave financiare vjetore të përgatitura në përputhje me ligjin 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

15.2 Bilanci vjetor duhet të paraqitet brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Kreu V

Asambleja e Përgjithshme

Neni 16

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

16.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë, por pa u kufizuar, për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a) përcaktimi i politikave tregtare;
- b) ndryshime të Statutit;
- c) emërimi dhe shkarkimi i administratorit/administratorëve;
- d) emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe/ose i ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
- f) mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga ana e administratorit/administratorëve, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
- g) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
- h) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- i) pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykime dhe në procedime të tjera kundër administratorit/administratorëve të saj;
- k) riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë;
- l) miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- m) miratimi i rregullores së shoqërisë dhe organogramës;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Statuti.

16.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi. nëpërmjet një njoftimi me e-mail drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga të gjithë ortaket që zotërojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

16.3 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përmbajë në mënyrë të qartë datën, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes, së bashku me dokumentacionin përkatës



dhe do t'u dergohen të gjithë Ortakëve të Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes.

16.4 Në rast ndryshimi të rendit të ditës, do të ndiqet e njëjta procedure njoftimi që përshkruhet më sipër.

Neni 17

Kuorumi i nevojshëm

17.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 31 për qind të kapitalit të shoqërisë.

17.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.

17.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 18

Marrja e vendimeve

18.1 Asambleja e Përgjithshme mund të kryejë mbledhjet dhe të marrë vendimet në takime që zhvillohen në person në vendin e miratuar, ose virtualisht "on line", në platformën elektronike të miratuar nga vetë Asambleja.

18.2 Vendimarrja e kryer në mbledhjet në person apo online kanë të njëjtën vlerë për Shoqërinë.

18.3 Asambleja e Ortakëve vendos me 3/4 të ortakëve zotërues të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

18.4 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të zakonshme si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- h) miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- i) miratimi i rregullores së shoqërisë dhe organogramës.



- 18.3 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 18.4 Kryetari i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme do të jetë njëri nga administratorët e shoqërisë, i cili do të drejtojë mbledhjen dhe Asambleja e Përgjithshme në çdo mbledhje të saj do të emërojë me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës edhe një person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.5 Çdo vendim i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohet në proces-verbal, i cili do të mbahet në perputhje me nenin 90 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 19

Votat e Ortakëve

- 19.1 Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.
- 19.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu VI

Administratori

Neni 20

Emërimi i Administratorit

- 20.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 20.2 Personat e mëposhtëm caktohet si Administratorë të shoqërisë “**RADO GROUP AL**” SH.P.K., të cilët ose së bashku, ose secili në mënyrë të vecantë/individuale mund të kryejnë veprimet e autorizuara në statut apo në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme:
- a) **KLODIAN RADO**, i biri i Balil, lindur më 26.08.1978, në Gjirokastrë, banues në Tiranë, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta shqiptare me nr. BB5216891 dhe nr. personal: H80826056E; për një afat 5 vjeçar, nga momenti i regjistrimit të këtij fakti pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
 - b) **REA GODO**, e bija e Artur, lindur më 16.06.1997, në Tiranë, banuese në Tiranë, Shqipëri, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi shqiptar me nr. 032957565 dhe nr. personal: J75616062V; për një afat

5 vjeçar, nga momenti i regjistrimit të këtij fakti pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 21

Kompetencat e Administratorit/Administratoreve

21.1 Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të kryhen nga Administratorët, të cilët në mënyrë të veçantë/individuale mund të kryejnë veprimet e autorizuara në statut apo në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

21.2 Të dy administratorët administrojnë bashkarisht shoqërinë, duke gëzuar të njëjtat kompetenca dhe tagra përfaqësimi, por përgjigjen individualisht për mirëadministrimin e shoqërisë. Administratorët nuk veprojnë si organ kolegjial. Secili përgjigjet individualisht për veprimet juridike të kryera gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si administrator.

21.3 Pa u kufizuar sa më sipër, në mënyrë të veçantë, Administratori ka këto kompetenca:

- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përsa i përket administrimit të zakonshëm;
- (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
- (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë më çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj;
- (iv) do të përgatisë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipotekë, peng apo çdo marrëveshje tjetër që krijon apo mund të krijojë një barrë mbi pasuritë e Shoqërisë, marrëveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë. Të gjitha veprimet e parashikuara këtu (pika iv) do të jenë të vlefshme nëse janë të autorizuara shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë unanime;
- (v) do të urdhërojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë - duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
- (vi) do të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- (vii) do të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- (viii) do të krijojë një sistem monitorimi dhe paralajmërimi njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- (ix) do të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 3 Maj 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- (x) do t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- (xi) do të marrë në punë, emërojë, shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për çdo nivel, përfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agentë, do të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do të përcaktojë shpërblimin e tyre, në përputhje me vendimin me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme.

- (xii) të përcaktojë strukturën e organizimit të Zyrës dhe përpiqet për përzgjedhjen e pjestarëve të saj, jo ortakë, në përputhje me vendimin me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme.
- (xiii) të grumbullojë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike të gjitha materialet teorike apo të jurisprudencës që lidhen drejtpërsëdrejti me mbarëvajtjen e punëve në Zyrë:
- (xiv) të organizojë manuale mbi kriteret e punësimit dhe testime profesionale për të gjithë kandidatët që kërkojnë të punojnë në Zyrë:
- (xv) të gjitha detyrat e tjera që i ngarkohen nga Mbledhja e Ortakëve.
- (xvi) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke pasur parasysh respektimin në cdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhëna me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

21.4 Asambleja e Përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa më sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve. Në cdo rast, zgjidhja e konflikteve do të tentohen me anë të mjeteve alternative të zgjidhjes së konflikteve (ndërmjetesimit apo arbitrazhit), dhe vetëm kur të tilla mjete kanë dështuar, mund të përdoren mjetet gjyqësore.

Neni 22

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

22.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a) shkarkohet, apo personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
- b) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- c) ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e paaftësisë fizike;
- d) jep dorëheqje nga detyra duke njoftuar shoqërinë;
- e) vdes;
- f) ndodhet në situata apo rrethana të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e detyrave të tij.

Neni 23

Kufizimet në Veprimet e Administratorit

23.1 Administratori, përvec rasteve kur lejohet me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve, nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë, në bazë të kuorumit të kërkuar, autorizon lidhjen e kësaj marrëveshje.

23.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



Kreu VII

Marrëdhëniet e punës

Neni 24

Punësimi

- 24.1** Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen nga kontrata individuale e punës, rregullat e këtij statuti dhe Kodi i Punës.
- 24.2** Administratori i Shoqërisë përcakton kritere për punësimin e stafit, përfshirë avokatëve, ndërmjetësve, agjentëve të pronave, asistentë avokatëve dhe punonjësit e tjerë teknikë të Shoqërisë.

Neni 25

Kontrata Individuale e Punës

- 25.1** Kontrata individuale e punës duhet të rregullojë:
- a) Marrjen në punë dhe kushtet e saj;
 - b) Llojin e punës që do të kryhet, profesionet ndihmëse, koha e punës ditore dhe javore, pushimet, shpërblimin për kohën e punës (mujor), shpërblimin për kohën jashtë orarit të punës, festave, ditëve të pushimit, bonuset për punë cilësore;
 - c) Rregulla mbi konfidencialitetin e punës, rregulla të etikës së punës dhe atë të marrëdhënieve me gjykatën apo institucione të tjera;
 - d) Përgjegjësitë e palëve për cënimin e kontratës së punës dhe rregullave të gjithë pranuar të punësimit.
- 25.2** Të punësuarit mbajnë përgjegjësi civile kur ata, me veprimet e tyre, i shkaktojnë një dëm pasuror Shoqërisë.

Kreu VIII

Prishja dhe njoftimet

Neni 26

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

- 26.1** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:
- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - d) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
 - e) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - f) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - g) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.



- 26.2** Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 26.3** Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKB-së.

Neni 27

Njoftimet

- 27.1** Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e emailit të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme, dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 27.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin në adresën e emailit që i është njoftuar shoqërisë nga ortakë. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 28

Të Ndryshme

- 28.1** Çdo dokument që lëshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vulën e saj.
- 28.2** Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohe pas kohe gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 28.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 28.4** Në fund të çdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilët i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 28.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

Neni 29

Dispozita përfundimtare

- 29.1** Ky statut përbën dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së cilësuar të përcaktuar më sipër.



- 29.2** Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.
- 29.3** Ortaku themelues i vetëm/Administrator Z. Klodian Rado identifikuar nga pasaporta me nr. BB5216891 dhe nr. personal: H80826056W, është përgjegjës për aplikimin dhe depozitimin e dokumentacionit pranë QKB, me qëllim regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar.
- 29.4** Ky statut u redaktua në 4 kopje origjinale të njëjta, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën Shqip dhe u nënshkrua nga palët pa asnjë rezervë.

Ortaku i Vetëm Themelues: Z. Klodian Rado

